

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vizita në Francë - DW: Atje ku dikur zhvilloheshin luftëra, Papa Leoni XIV tani bën thirrje për paqe
ADRESA	https://www.syri.net/bote/919860/dw-atje-ku-dikur-zhvilloheshin-luftera-papa-leoni-xiv-tani-ben-thirrje-per-paqe/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:16:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 07:43:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	66f5faae4f04db3e166253b1fe1de4c132add732b81015699ff08e31315e4770
TEKSTI	d8afdc0d614c055c37c5239cc033e9561fbe7f5db7cda7067aa0c69f1d82fffb
PAMJA	5b76142fc60c5ebc91584e96d093d8542306c674734d6cf3f93862ff61b14aa8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7dd867acd457e54d7faef74118f55d80084a6ba038c879aea603bfc898b0e280
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7dd867acd457e54d7faef74118f55d80084a6ba038c879aea603bfc898b0e280>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**GENC POLLO**

Dy Edi Ramat në Nju Jork dhe raporti i sikletshëm me të tashmen e të shkuarën

**KIM MEHMETI**


Piktori do të lërë emër në histori, por si 'kreu i qelbësirave' dhe antishqiptar i përbetuar!



DW: Atje ku dikur zhvilloheshin luftëra, Papa Leoni XIV tani bën thirrje për paqe

09:43, 29/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



"Kontributi që një Evropë e organizuar dhe e gjallëruar mund t'i japë qytetërimit është i domosdoshëm për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore." Në ditën e fundit të vizitës së tij katërditore në Francë, Papa Leoni XIV, në fjalimin më të rëndësishëm politik të udhëtimit, theksoi rëndësinë e Evropës dhe i bëri thirrje asaj të angazhohet më shumë për paqen në kontinent, si dhe të mbetet e hapur ndaj migrantëve.

Në qytetin Metz, në lindje të Francës, Papa u bëri thirrje evropianëve për një "dialog me durim" për të kapërcyer luftën e Rusisë kundër Ukrainës. Për këtë, sipas tij, nevojitet "guxim në negociata" dhe gatishmëria për të "hequr dorë nga disa pozicione për të mirën më të madhe të paqes".

Në fushëbetejat e dikurshme

Fjalët e tij u thanë në një vend në lindje të Francës që, si pak vende të tjera, pasqyron historinë e trazuar të Evropës. Metz ndodhet në një rajon që gjatë shekullit të kaluar ka ndryshuar disa herë përkatësinë shtetërore. Pas Luftës Franko-Gjermane të viteve 1870/71, qyteti i përkiste Perandorisë Gjermane; pas Luftës së Parë Botërore u rikthye në Francë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u pushtua sërish nga Gjermania, përpara se në vitin 1944 të bëhej përsëri francez. Shumë toka bujqësore në këtë zonë ishin dikur fusha betejë.

Pikërisht për këtë arsye, Metz ka sot një rëndësi të madhe simbolike. Qyteti përfaqëson transformimin nga armiqësia në bashkëpunim. Armiqtë e dikurshëm janë bërë partnerë të ngushtë që sot mbështesin së bashku procesin e integrimit evropian.

Pse Metz?

Vetë Papa kishte insistuar që mesazhin e tij për paqen ta përcillte nga Metz. Këtë e bëri të ditur kryetari i Konferencës së Ipeshkvijve të Francës, Kardinali Jean-Marc Aveline, pak para fjalimit të Papës. Destinacionet Paris dhe Lourdes ishin vendosur që më parë. Gjatë planifikimeve, Aveline i kishte propozuar Papës edhe disa vende të tjera në Francë, përfshirë edhe Metzin. Në takimin e radhës, Leoni

më të lexuarat

Të arrestuarit pranë bazës ushtarake britanike lirohen me kusht, policia: Hetimi vazhdon

Zjarr i fuqishëm në fabrikën e fishekzjarreve në Rusi, 13 të vdekur

Ambasadori amerikan: Trump e paralajmëroi Xinë që të mos e mbështesë Iranin

Presioni i protestave, jep dorëheqjen presidenti i Serbisë, Aleksandër Vučić

Gjykata italiane dënon me 10 vite burg 3 agjentë egjiptianë për rrëmbimin e Giulio Regenit

Donald Trump: Iranit nuk i kam ofruar asgjë për lehtësimin e sanksioneve

kishte zgjedhur menjëherë Metzin, "për shkak të Evropës".

Vizita në Metz u shndërrua në një homazh për Robert Schumanin. Schumani (1886-1963), i lindur në Luksemburg dhe me shtetësi fillimisht gjermane, ishte një burrë shteti francez dhe një nga etërit themelues të idesë së Evropës së bashkuar pas Luftës së Dytë Botërore.

Si ministër i Jashtëm i Francës, ai promovoi pajtimin franko-gjerman, punoi për bashkimin e Evropës dhe në vitin 1958 u bë presidenti i parë i Parlamentit Evropian. Në një kishë të vogël pranë Metzit, ku kishte jetuar për shumë vite, ai u varros pas vdekjes. Prej më shumë se 30 vitesh po zhvillohet një proces kishtar për lumnimin e tij.

Edhe qendra e kongreseve ku foli Papa mban emrin e tij: Qendra e Kongreseve "Robert Schuman". Në fjalimin e tij, Papa e citoi Schumanin më shpesh sesa papët paraardhës që përmendi. Ai tha: "Schumani, i cili përjetoi kufij shtetërorë që ndryshonin vazhdimisht, ndihmoi në vendosjen e themeleve të një Evrope që ishte e vetëdijshme për urgjencën e rrëzimit të mureve që e ndanin."

Kritika ndaj riarmatosjes

"Sot marrëdhëniet mes njerëzve dhe mes shteteve po bëhen gjithnjë e më barbare", tha Papa gjatë thirrjes së tij për një Evropë të bashkuar dhe paqësore. Kontinenti që pas vitit 1945 arriti të kapërcejë urrejtjen dhe armiqësinë mund t'i japë fund kësaj spiraleje negative. Sipas tij, e drejta ndërkombëtare dhe multilateralizmi janë kundërpeshat më të mira ndaj çdo vullneti për dominim që mbështetet te konfliktet. Përballë kësaj, ai vendosi atë që e quajti "iluzioni i riarmatosjes".

Kur theksoi rëndësinë e së drejtës ndërkombëtare dhe të rregullave detyruese ndërkombëtare, fjalimi i Papës së parë amerikan në krye të Kishës Katolike u perceptua gjithashtu si një kritikë ndaj politikës së SHBA-së nën presidentin Donald Trump, i cili është fokusuar në forcimin e pushtetit të vet dhe ka hequr dorë nga shumë angazhime ndërkombëtare të vendit të tij.

A po i referohej Trumpit?

Pak para nisjes nga Roma, Papa përshëndeti gazetarët që e shoqëronin në avion. Midis tyre ishte edhe korrespondenti i CNN-it, i cili e pyeti për përjashtimin e mediave kritike, përfshirë CNN-in, nga raportimi në Shtëpinë e Bardhë.

"Në avionin e Papës të gjithë janë të mirëpritur", u përgjigj Leoni. Për të, është "shumë e rëndësishme që raportimi të jetë i plotë dhe që kushdo të ketë mundësinë e informimit". Edhe në apelin e tij për trajtimin njerëzor dhe dinjitoz të refugjatëve mund të vëreheshin paralele me situatën aktuale në SHBA.

Megjithatë, në këto tema politike, Papa nuk theksoi vetëm distancën nga administrata aktuale në Uashington. Fjalimi i tij, në çdo pjesë ku shprehte vlerësim për idenë evropiane dhe për evropianët, tingëllonte si një kundërpërgjigje e qetë ndaj Papa Françeskut.

Papa Françesku, jezuiti nga Argjentina, gjatë udhëtimeve të tij në Evropë preferonte të vizitonte periferitë e kontinentit, kampet e refugjatëve dhe njerëzit e marginalizuar. Ai nuk arriti kurrë në Paris, Berlin, Vjenë apo Madrid. Që në vitin 2014, në fjalimet para Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës në Strasburg, Françesku kishte kritikuar ashpër një Evropë të lodhur dhe pa energji.

Kritikë ndaj legalizimit të eutanazisë

Leoni tingëlloi dukshëm ndryshe nga paraardhësi i tij. Megjithatë ai theksoi edhe përgjegjësinë e evropianëve. Kjo përfshinte mbrojtjen e pakushtëzuar të jetës dhe refuzimin e çdo forme të eutanazisë. Në Francë, gjatë verës, eutanazia u lejua me ligj në kushte të kufizuara, ndërsa në disa vende të tjera evropiane po zhvillohen diskutime të ngjashme për rregullime ligjore.

Edhe presidenti francez Emmanuel Macron, mandati i të cilit përfundon pas pak muajsh, në frymën e Schumanit foli për një "Evropë që mbron, bashkon dhe vepron". Sipas tij, kjo Evropë duhet të jetë "sovrane, e bashkuar dhe demokratike", e frymëzuar nga projekti i paqes dhe mirëqenies që synuan etërit themelues.

Metz, një nga vendet në zemër të Evropës së dikurshme të shkatërruar nga luftërat, u bë për Leonin një shembull pozitiv përballë konflikteve që vazhdojnë në botë. Metz dhe rrethina e tij dëshmojnë se "pajtimi është i mundur vetëm kur ekziston guximi për të thyer zinxhirin e mllëfit", tha ai në paraqitjen e tij të fundit publike gjatë kësaj vizite, në predikimin në katedralen e qytetit.

Edhe aty, ashtu si në çdo ditë të kësaj vizite në Francë, Papa u prit me duartrokitje dhe entuziazëm./DW/

Sulme ruse mbi Kiev - breshëri raketash dhe dronësh, Ukraina aktivizon mbrojtjen ajrore



Gazetari i CNN përball Vuçiçin me të kaluarën e Serbisë: Kur Perëndimi mendon për ju, i kujtohen luftërat në Ballkan



Paralajmërimi i inteligjencës daneze: Rusia do të sulmojë NATO-n

Lexo edhe:



OpenAI i kërkon falje Australisë për aksesin e paautorizuar të IA-së në faqet qeveritare



Pushtuesit izraelitë sulmojnë 3 fshatra në Bregun Perëndimor, djegin shtëpi dhe automjete



Kina i kërkon Japonisë të 'korrigjojë' qëndrimin e udhëheqëses ndaj Tajvanit

TË NGJASHME



Milei kërcënon Britaninë: Dy javë afat për ndalimin e kërkimeve për naftë në Ishujt Falkland



Korea e Jugut, hetim të plotë për shpërthimin e minës tokësore në Zonën e Demilitarizuar



Protestë pranë kullës Eiffel, zjarrfikësit francezë kërkojnë më shumë mjete për të përballuar zjarret masive



Përmytjet prekin mbi 2.6 milionë njerëz në Tajlandë



Konfirmohet vrasja e komandantit të Hamasit në sulmin në Gaza



Irani: Katari do t'i paraqesë SHBA-së ide të reja, me synim rihapjen e Ngushticës së Hormuzit



'Sulmi' në bazën amerikane në Britani/ Lirohen me kusht 5 të arrestuarit. Telefonata e gruas zbuloi rastin...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net